



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 208 Prot.

Tiranë, më 08.03 2016

VENDIM Nr. 8, datë 29.02.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, të datës 29.02.2016, pasi shqyrtoi Relacionin mbi gjetjet arkeologjike në fshatin Vithkuq-Korçë, në kuadër të *projektit TAP, për rrugën ndihmëse Nr. 443*, paraqitur nga TAP dhe relacioni i verifikimit në terren, realizuar nga ASHA dhe DRKK Korçë,

VENDOSI:

- I. Të miratojë Relacionin mbi gjetjet arkeologjike në fshatin Vithkuq-Korçë, në kuadër të *projektit TAP, për rrugën ndihmëse Nr. 443*, paraqitur nga TAP dhe relacionin e verifikimit në terren, realizuar nga ASHA dhe DRKK Korçë.
- II. Pasi të kryhet dokumentimi i fragmenteve të mureve të ekspozuara, të realizohet ribulimi i tyre.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO